

VENDIM
Nr.225, datë 29.5.1992

**PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË USHTARAKËVE QË DALIN NË LIRIM NGA ZBATIMI
I REFORMËS NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA**

Për kryerjen e reformës së riorganizimit të Forcave të Armatosura, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Oficerët, nënoficerët dhe policët e shërbimit aktiv, që deri më 30.8.1993 mbushin moshën 50 vjeç e lart për burrat dhe 45 vjeç për gratë, dalin në lirim. Në raste të veçanta, me miratim të titullarit të dikasterit, mund të vazhdojnë të mbeten në punë persona të veçantë.

Mund të nxirren në lirim me urdhër të ministrit ose të drejtorit të SHIK-ut, edhe me moshë më të ulët se 50 vjeç për burrat dhe 45 vjeç për gratë.

2. Ushtarakët e shërbimit aktiv që kanë vjetërsi shërbimi 15 vjet burrat dhe 12 vjet gratë e që nxirren në lirim gëzojnë shpërblim të pjesshëm në masën 60 për qind të pagesë bazë mujore (pa shtesat për gradat, vjetërsinë dhe vështirësinë) kur nxirret në lirim.

Ata që kanë vjetërsi shërbimi: burrat mbi 15 vjet dhe grate mbi 12 vjet, për kohën deri në daljen në pension pleqërie përfitojnë edhe një shtesë 2 për qind të pagesës mujore për çdo vit tjetër shërbimi mbi kufirin e mësipërm, por jo më shumë se 20 për qind shtesë.

Ushtarakët që nuk kanë plotësuar vjetërsinë e shërbimit 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë, ju ulet 0.5 për qind e pagesë mujore për çdo vit që kanë më pak se kufiri i mësipërm, por jo më shumë se 5 për qind dhe jo më pak se paga minimale e përcaktuar në ligjin e asistencës.

3. Ushtarakët që kanë më pak se një vit vjetërsi shërbimi dhe nuk kanë mbaruar shkollë ushtarake nuk përfitojnë shpërblim të pjesshëm sipas nenit

2. Ata dalin në asistencë si punonjësit që preken nga reforma ekonomike.

4. Për efekt të caktimit të pagesë mujore, oficerëve, nënoficerëve dhe policëve aktivë në vjetërsinë e shërbimit ushtarak, u llogaritet:

a) Koha e kaluar në shërbim ushtarak aktiv të detyruar.

b) Koha e rregullt e përfundimit të mësimave si kursant e student ushtarak në shkollat ushtarake, si dhe në shkollat e larta civile, në rast se janë përgatitur si kontigjent për Forcat e Armatosura.

c) Periudha nga dita e titullimit si ushtarak aktiv deri në ditën e daljes së urdhrat për lirimin nga Forcat e Armatosura.

ç) Koha e rregullt e përfundimit të kurseve të ndryshme të kualifikimit e specializimit brenda e jashtë vendit.

d) Koha e kaluar për nevoja pune e shërbimi në organet shtetërore ose në organizmat politiko-shoqërorë në interes të mbrojtjes.

e) Koha e kaluar në burgje ose në internim, në rast se është fituar pafajësia.

f) Koha e punuar në punë të kategorisë së parë e të dytë, të përcaktuara sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.526, datë 20.12.1958 "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni".

U llogaritet vit i plotë shërbimi të gjithë ushtarakëve që ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi kanë plotësuar kohën 6 muaj e 1 ditë.

5. Ushtarakëve që nxirren në lirim, sipas këtij vendimi, u jepet një ndihmë e menjëhershme në shumën e një page mujore.

6. Ushtarakët e dalë në lirim sipas këtij vendimi, kur punojnë si civilë pranë personave juridikë e fizikë vendas ose të huaj dhe kanë të ardhura që kalojnë 50 për qind shpërblimin e caktuar me këtë vendim, humbin këtë shpërblim përkohësisht.

7. Shpërblimet që përfitojnë sipas këtij vendimi, në çdo rast ngrihen në raport me rritjen e pagave të ushtarakëve në shërbim aktiv, si dhe me indeksimin e çmimeve e tarifave.

8. Për zbatimin e këtij vendimi, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Shërbimi Informativ Kombëtar, nxjerrin udhëzimet përkatëse.

9. Trajtimi financiar sipas këtij vendimi përfshin vetëm ushtarakët që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksander Meksi